




GUIDË

2013

LUMI NERETVA, BOSNJE E HERCEGOVINË
© MICHEL GUNTHER / WWF-CANON

HIDROENERGJIA E QËNDRUESHME NË HARKUN DINARIK

Udhëzues i shkurtër për investitorët



DIGA E GRABOVICËS, BOSNJE E HERCEGOVINË. © MICHEL GUNTHER / WWF-CANON

www.dams.org/report
www.unep.org/dams/WCD

Nevojat botërore për ujë dhe energji janë në rritje të shpejtë dhe nëse këto nevoja nuk plotësohen në mënyrë të qëndrueshme kostot – qoftë ekonomike, sociale apo mjedisore – do të jenë të mëdha. Me këtë udhëzues WWF-i jep kontribut në qasjen e re të vendimarrjes duke i ofruar investitorëve dhe punëdhënësve një pasqyrë të detajuar të përfitimeve, kostove dhe rreziqeve që duhen marrë parasysh gjatë planifikimit të investimeve në ndërtimin e digave, dhe veçanërisht në hidroenergji.

Përfaqja e WWF-it ndaj digave dhe hidroenergjisë

Digat mund të sjellin përfitime domethënëse për njerëzit të cilët furnizohen me energji elektrike nga hidrocentralet, me ujë për vaditje dhe mbrohen nga vërshimet e ujit, apo një kombinim të të gjithë këtyre përfitimeve. Megjithatë ndikimet e digave në mjedis – sidomos në ekosistemet e ujërave të ëmbëla – dhe në jetën e njërëzve janë gjithmonë të konsiderueshme, dobitë nga to ndonjëherë janë të mbivlerësuara duke anashkaluar kostot sociale dhe mjedisore. Është me rëndësi që të evitohen ndikimet e pafavorshme sociale dhe mjedisore të një infrastrukture të tillë dhe të sigurohet që paratë e investitorëve – si dhe të taksapaguesve – shpenzohen me efikasitet. Projektet e hartuara keq, parashikimi i tepruar i kthimit të investimeve dhe rrezikimi i reputacionit i ka kthyer shumë projekte në diga në investime të rrezikshme.

Zbatimi i një sërë rekomandimesh të përcjella nga Komisioni Botëror i Digave (WCD), përfshirë vlerësimet e plotë të nevojave dhe mundësive, përfshirjen e aktorëve dhe shmangien ose minimizimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale, do ndikonte ndjeshëm në zvogëlimin e rrezikut të investimeve.

Ky dokument ofron rekomandime dhe informacione për aktorët kryesor, veçanërisht investitorët dhe zbatuesit e projekteve, të bazuara në përfaqsimin e WWF-it ndaj digave dhe hidroenergjisë; ka për qëllim të ndihmojë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në lidhje me këtë infrastrukturë për të siguruar kthimin më të mirë të investimeve të bëra me kosto më të vogël për mjedisin.

Përse digat dëmtojnë ekosistemet e ujërave të ëmbëla?


50,000 diga të mëdha në botë kanë krijuar një ndikim të jashtëzakonshëm në ekosistemet e ujërave të ëmbëla. Së bashku me kanalet dhe ndarësit janë përgjegjëse për fragmentimin e më shumë se 60% të lumenjve më të mëdhenj të botës. Digat gjithashtu kanë kontribuar në humbje të mëdha të biodiversitetit të ujërave të ëmbëla. Numri i më shumë se gjysmës së afër 200 specieve kryesore të ujërave të ëmbëla është zvogëluar dhe, nga rreth 177 lumenjë në botë me gjatësi më të madhe se 1,000 km, vetëm rreth një e treta ruan rrjedhën e lirë sipas Raportit të fundit mbi Planetin e Gjallë të WWF-it.

www.panda.org/lpr

Trendet e numrit të lumenjve me derdhje të lirë më të gjatë se 1,000 km në botë.
 Trendet para vitit 1900 deri në ditët tona dhe parashikimet deri më 2020

Krahasuar me numërin e lumenjve në të cilët tashmë janë vendosur diga.

WWF 2006.



Nga pikepamja mjedisore digat të cilat ndikojnë në zonat e mbrojtura apo ato të rëndësishme ndërkombëtare, siç janë ligatinat e përcaktuara sipas Konventës Ramsar, krijojnë më së tepërmi shqetësime.

www.ramsar.org

Në shumë raste, megjithatë, ndikimet e mëdha mund të zvogëlohen, nëse jo të anashkalohen, përmes masave të cilat kufizojnë dëmtimin e mjedisit. Kjo qasje duhet të konsiderohet si lehtësuese dhe mund të arrihet përmes hartimit dhe zbatimit efikas të kornizave ligjore dhe rregulloreve si edhe stimulujve të duhur të tregut. Në Ballkanin Përendimor, për shembull, Kroacia dhe Bosnja-Hercegovina e kanë përafruar legjislacionin mbi ujërat me Direktivën Kornizë të Ujërave konform anëtarësimit të ardhshëm në BE. Zvicëra, në anën tjetër, ka zgjedhur qasjen e stimulimit nga tregu, duke shfrytëzuar kërkesën për energji të pastër por në zbatim dhe me drejtim nga investimet e masat mjedisore për digat ekzistuese.

Si të bëhen digat të qëndrueshme

Me publikimin e raportit të Komisionit Botëror të Digave, vendimarrësit në tërë botën tani kanë qasje në disa rekomandime të cilat paraqesin rrugën për të rritur qëndrueshmërinë e hidroenergjisë dhe zvogëluar rrezikun social dhe mjedisor në zhvillimin e digave. Sugjerimet për përmirësimin e qëndrueshmërisë së digave përfshijnë në mënyrë specifike:

- Marrjen e përkrahjes publike të bazuar në të dhëna të besueshme për t'ju mundësuar njerëzve – aktorëve kryesor institucional dhe banorëve lokal njëkohësisht – pjesëmarrje e plotë në marrjen e vendimeve.
- Vlerësimi i të gjitha opsioneve, duke siguruar që aspektet sociale dhe mjedisore kanë të njëjtën peshë me argumentat teknik, dhe duke analizuar digat ekzistuese në aspektin teknik dhe social.
- Nxerrja e përfitimit maksimal nga digat ekzistuese para ndërtimit të të rejave.
- Shpërndarja e njohurive mbi ekosistemet ujore dhe ruajtjen e tyre përgjatë tërë rrjedhjes së lumit.
- Shpërndarjen e dobive nga digat.
- Garantimin e ndërtimeve në bazë të standardeve më të mira të miratuara.
- Adresimin e ndikimeve ndërkufitare, sidomos në skemat të cilat përfshijnë diversitetin e ujit.

NË VITET E FUNDIT, EKOSISTEMET E UJËRAVE TË ËMBËLA NË EUROPËN JUGLINDORE JANË PREKUR NGA NEVOJA NË RRIJTJE PËR HIDROENERGJI, DUKE ÇUAR NË HUMBJE TË BIODIVERSITETIT QË NË DISA VENDE ËSHTË I PAKTHYESHËM. NJË NUMËR I MADH DIGASH – TË MËDHA DHE TË VOGËLA – JANË TË PLANIFIKUAR OSE DUKE U NDËRTUAR NË RAJON.

www.dams.org/report

Kur është e përshtatshme të investohet në diga?

Në fazën e studimit është me rëndësi që zbatuesit të bëjnë një sërë vlerësimesh paraprake për të përcaktuar nëse projekti i tyre paraqet alternativën më të mirë për zhvillimin e energjisë në rajonin në fjalë. Këto janë kryesisht:

Vlerësimi i nevojave

Për një investim të madh si ato të digave, është thelbësor vlerësimi i saktë i nevojave përndryshe projekti nuk do arrijë të plotësojë qëllimet e tij dhe të krijojë kthimin mbrapsht në masën e duhur të investimit. Kjo sidomos vlen për një projekt dige në të cilin do të shpenzohen burime të konsiderueshme financiare të një vendi për disa vite – duke pritur, natyrisht, që kjo do t'i ketë efekt të dukshëm në ekonominë e vendi në një periudhë afatgjatë.

Vlerësimi i opsioneve alternative

Nëse është përcaktuar nevoja e saktë, ekzistojnë dy arsye për të kërkuar alternativa. Së pari, diga do të jetë më e pranueshme politikisht për aktorët kryesor nëse do mund të tregohet që të gjitha alternativat janë marrë parasysh dhe, aty ku është e mundur, janë zbatuar. Së dyti, nëse nuk ka alternativa ekonomikisht të vlefshme, atëherë ndërtimi i digës është më lehtë të arsyetohet nga aspekti financiar.

Shqyrtimin e vazhdueshëm

Meqëse se mund të marrë më tepër se sa një dekadë kohë nga propozimi fillestar deri në ndërtim të digës, çdo herë ekziston mundësia e ndryshimeve të mëdha të cilat do të ndikojnë në vlerësimin e nevojave dhe alternativave, në nivel kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Në nivel kombëtar, mund të krijohet një qeveri e re me të tjera prioritete apo ndryshime të mëdha të politikave kombëtare. Ndryshimet e rëndomta të jashtme mund të vijnë nga ndryshimet e çmimit të karburantëve të fosileve. Ndryshimet e tilla mund të kenë ndikim të shpejt në përllogaritjet e përfitimeve financiare të digës ose, në rast më dramatik, të zhdukin nevojën për ndërtimin e saj.

Çfarë duhet të anashkalohe kur investohet në diga

Është me rëndësi që të gjitha rreziqet janë marrë parasysh dhe janë vlerësuar në një fazë të hershme të planifikimit të projektit. Kjo mund të bëhet përmes shtrimit të pyetjeve të cilat adresojnë rreziqet natyrore (p.sh. klima apo gjeologjia), rreziqet politike dhe ndryshimin e shprehive globale të konsumit. Niveli i detajeve që do japin përgjigjet nga këto pyetje, varet nga rreziku për rezultatin e kënaqshëm. Gjërat të cilat duhen evituar më së shpeshti gjatë investimit në diga janë:

Projektimi tepër optimist i përfitimeve: Analiza e bërë nga WCD ka rezultuar me faktin që kostot zakonisht nënvlerësohen përderisa përfitimet (siç janë energjia e fituar, ujitja, furnizimi me ujë i banesave dhe industrisë, lundrimi, rekreacioni dhe peshkimi) mbivlerësohen.

Tejkalimi i kohës dhe kostos: Ndërsa menaxhuesit e projektit zotohen se do të zbatojnë “në kohë, brenda buxhetit dhe sipas specifikimeve”, fatkeqësisht, në shumicën e skemave, i pari prej këtyre çaqeve zakonisht nuk arrihet. Tejkalimet e kohës janë të ndërlidhura zakonisht me planifikim joreal, të shpejtë dhe me mbivlerësim të buxhetit fillestar.

Vlerësimi i pasaktë i ndikimeve në jetën e njerëzve: Mëqenëse është relativisht e lehtë përmes hartave topografike dhe nivelit më të lartë të përcaktuara të ujit, të vlerësohet shtrirja e hapësirës e cila do të përmblytet nga uji me ngritjen e digës, ndikimet tek personat e zhvendosur dhe ata që jetojnë poshtë rrjedhës, jetesën e tyre dhe ndikimet e gjëra mjedisore paraqesin çështje shumë më të vështira. Për këtë arsye duhet të hartohet raporti për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA) nga ana e ekspertëve të pavarur me njohuri të vlerësuar në këtë fushë.


Kostot e mirëmbajtjes dhe operimit: Përderisa kostoja initiale e ndërtimit të digës do të jetë e madhe, edhe kostot tjera që do dalin mund të përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kalkulimit financiar. Në përgjithësi, kostot e funksionimit (p.sh. stafi për mirëmbajtjen e operacioneve dhe paisjet) të digës në vetëvetë janë relativisht të kuptuara mirë. Ajo çfarë shpeshherë nuk kuptohet siç duhet janë kostot e mirëmbajtjes dhe të operimit në krahasim me përfitimet të cilat pritet të sjellë diga. Kostot tipike përfshijnë shpërndarjen e re dhe kanalet e kullimit për ujitje, linjat e reja të energjisë dhe transformatorët e hidroenergjisë. Të gjitha digat bëhen më të shtrenjta për t'u mirëmbajtur kur janë në gjendje strukturore të ndjeshme gjatë vjetërsimit.

Rreziku madhor: Rreziku madhor përfshin mundësinë që në një vend të krijohen kushte të caktuara të cilat do të pengojnë rikthimin e parave në atë vend. Në një projekt me digë të madhe, me një periudhë të gjatë të ndërtimit dhe pune, këto rreziqe nuk mund të përcaktohen në mënyrë të përshtatshme në një fazë të hershme. Në rast të marrjes së kredive me kamatë të ulët dhe të pranishme të lartë të rreziqeve madhore, mund të krijohen disa mekanizma të sigurimit të pagesave për të mbrojtur investuesin nga mospagesat e mundshme në të ardhmën. Kjo mund të krijojë kosto më të madhe të projektit të digës dhe duhet të vlerësohet plotësisht para se të paraqitet projekti i digës.

Korrupsioni: Korrupsioni është i ndërlidhur me një numër projektesh të digave dhe shumat e dhëna nëndorë në projekte të tilla mund të jetë tepër e madhe. Diga në Itaipu në kufirin mes Brazilit dhe Paraguajit, për momentin diga me e madhe hidroenergjetike në botë, është përshkruar si një “monument i korrupsionit”. Një prej masave të cilat investitorët mund të ndërmarrin për të vlerësuar rrezikun e mundshëm të korrupsionit është të shohin renditjen e vendit përkatës në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International.

Jostabiliteti gjeologjik dhe dështimi i digës: Vendodhjet e digave janë, për nga vetë natyra e tyre, të ndjeshme ndaj aktiviteteve sizmike. Digat janë të ndërtuara në luginat dhe forma e tyre ndikon në përmasat e murit të digës dhe në sasinë e ujit të mbledhur. Megjithatë, në këto luginat mund të ketë erozion në kuptimin gjeologjik. Kjo do të thotë se ndërtimet në lartësi janë të lidhura me një stabilitet të ulët gjeologjik.

Mbulimi i shpenzimeve dhe përfitimet nga diga: Për shumë arsye digat të cilat ofrojnë hidroenergji, ujitje, peshkim dhe/ose kontroll të përmblyetjeve, gjatë përcaktimit të shpenzimeve të ndryshme duhen të krijojnë një formulë të shpërndarjes së koston tek përdoruesit e ndryshëm. Nuk është e pazakontë që hidrocentralet të subvencionojnë përdoruesit tjerë.



BRENDA DIGËS DYKOMESHE TË ITAIPUS, BRAZIL/ARGJENTINË © WWF / A. KLAUSCHEN

**TRANSPARENCY
INTERNATION KA
RAPORTUAR QË SEKTORI
I NDËRTIMIT DHE
INFRASTRUKTURËS
MENDOHE TË KETË
NIVELIN MË TË LARTË TË
KORRUPSIONIT NGA TË
GJITHË SEKTORËT TJERË,
MË TË LARTË SE SA
INDUSTRIA E ARMËVE DHE
SEKTORI I NAFTËS DHE
GASIT.¹**

www.transparency.org

**Protokoll i Vlerësimit
të Qëndrueshmërisë
së Hidroenergjisë i
IHAs ofron një listë të
detajuar të rreziqeve
potenciale të cilat
duhen marrë parasysh
nga ndërtuesit dhe
investitorët.**

www.hydrosustainability.org

¹O'Leary D. (2006) The Role of Transparency International in Fighting Corruption in Infrastructure. <http://siteresources.worldbank.org/INTDECABCTOK2006/Resources/O'Leary.pdf>



Si të minimizohen ndikimet në mjedis të digave

Përcaktimi i flukseve mjedisore

Përfitimi maksimal i energjisë elektrike apo shkarkimi mund të kenë pasoja serioze edhe për ekosistemin edhe për përdoruesit tjerë poshtë rrjedhës.

Ndryshimi i regjimit të operimit të digave për të imituar natyrën – krijimi i një regjimi të rrjedhës mjedisore – është njëra prej masave kryesore lehtësuese që mund të ndërmerren. Në shumë raste është e mundur të bëhen përshtatje në punën e digës për të plotësuar nevojat e ndryshme edhe në projektet ekzistuese edhe ato të planifikuara.

Rrjedhje mjedisore nuk janë të njëjta me “rrjedhjet minimale” të cilat janë përgjithësisht të pranura nga projektet apo përdoruesit e digave. As nuk janë kopje e saktë e atyre që quhen rrjedhje natyrore. Ato duhet të përfshijnë volumin e ujit, cilësinë dhe kohën si dhe sedimentin e transferit për të mbuluar nevojat e ekosistemeve dhe komuniteteve poshtë rrjedhës.

Mbrojtja e peshkimit

Digat mund të kenë efekte shkatërruese për peshqit (përmes bllokimit të lëvizjes në vendin e hedhjes së vezëve për shembull). Megjithatë, tani kalimet për peshqit janë zakonisht të përfshira në planin e digave dhe është e mundur që e njëjta të bëhet edhe për digat ekzistuese. Ka ndërtime të ndryshme dhe mundësi për të lehtësuar kalimin e peshqëve por suksesi varet nga plani, funksionimi dhe mbikqyrja ashtu si edhe nga speciet e prekura nga ndertimi i digës.

Habitatet e peshqëve në ligatina poshtë rrjedhës mund gjithashtu të shkatërrohen ose të devijohen nga ndryshimet në rrjedhën e ujit, temperaturës dhe nivelit të oksigjenit. Tendenca për të kompensuar këtë përmes krijimit të veprimtarisë së peshkimit në rezervuar – duke përfshirë edhe specie joautoktone – apo në ujëra fundor mund të dëmtoj biodiversitetin edhe pse mund të krijoj përfitime sociale dhe ekonomike. Duhet shumë kujdes në evitimin e ndikimeve në llojet autoktone të peshqëve nga futja e specieve tjera të huaja.

Krijimi i zonave nën mbrojtje të posaçme

Në shumë vende, fragmentimi i lumenjëve nga digat do të thotë që shumë pak lumenjë kanë mbetur në gjendjen e tyre natyrore. Kjo ka rezultuar me humbje të madhe të ligatinave dhe ekosistemeve tjera të ujërave të ëmbëla. WWF beson që qeveritë duhet të shpallin disa prej lumenjve të mbetur të padëmtuar nga ndërhyrjet, nën mbrojtje të posaçme si zona “të ndaluara” për skema hidroenergjitilke.

Për shembull në Islandë, ku hidrocentrali Karahnjúkar do të shkaktoj dëme të konsiderueshme në dy lumënjtë e akullnajave, WWF është duke nxitur qeverinë Islandeze që të mbrojë lumin e tretë të akullnajave, Jökulsá á Fjöllum, përfshirë edhe shpalljen e tij si zonë Ramsar.

Më shumë informacione për prioritetet në ujërat e ëmbëla mund të gjenden në publikimin e fundit të WWF “Lumenjtë për jetën: raste të prioritetëve të ruajtjes së ujërave përkrah zhvillimeve infrastrukture”.

http://awsassets.panda.org/downloads/wwf_guide_water_for_life_web.pdf

Fotot nga lart:

Burimet e Drinit të Zi. Liqeni i Ohrit, IRJ e Maqedonisë.

© WWF / A. Klauschen

Peshkatari dhe barbuni. Liqeni i Shkodrës, Mali i Zi.

© Michel Gunther / „WWF-Canon

Liqeni i Shkodrës, Mali i Zi.

© Michel Gunther / „WWF-Canon

3 mënyra në të cilat investitorët mund të demonstrojnë praktikën e mirë

1

**Përshtatja e
lidhjeve dhe
rregullore të
BE-së**

<http://eur-lex.europa.eu>
<http://ec.europa.eu>

Përputhja me kornizën përkatëse ligjore të BE-së, saktësisht Direktivën Kornizë për Ujërat, Direktivën e Shpendëve dhe Habitatin, si edhe Direktivën për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (EIA) e Vlerësimin Strategjik Mjedisor (SEA) është mënyrë e mirë që investitorët dhe ndërtuesit të sigurohen që kanë ndërmarrë të gjitha masat përgjatë zhvillimit dhe financimit të projekteve të reja infrastrukturore. Përderisa përputhja është e detyrueshme vetëm brenda Bashkimit Europian, përshtatja me *acquis communautaire* është një kusht i rëndësishëm që kërkohet për vendet në proces të integritimit në BE dhe investitorët, sikurse edhe ndërtuesit duhen të kenë parasysh faktin që herët osë vonë duhet të adresojnë këtë detyrime.

Bërja e vlefshme për publikun e informacioneve dhe përfshirja e palëve të interesuara në marrjen e vendimeve, siç kërkohet nga legjislacioni i BE-së (shih Konventën e Aarhusit-Direktivën e ngjashme), mund të forcojë në masë të madhe përkrahjen e publikut për projekte të reja infrastrukturore pasi që ky proces kërkon më tepër transparencë dhe qasje më të besueshme të qeverisë.

2

**Përdorni skema
të certifikimit
dhe vlerësime
vullnetare**

Ekzistojnë disa iniciativa të sektorit privat për përmirësimin e praktikave në zhvillimin e infrastrukturës, përfshirë digat dhe hidroenergjinë, në baza vullnetare, pa obligime ligjore. Më poshtë do i tregojmë shembujt e përpjekjeve interesante të cilat do të mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë e sektorit të hidroenergjisë që janë të përkrahura nga WWF.

PROTOKOLLI PËR VLERËSIMIN E QËNDRUESHMËRISË SË HIDROENERGJISË PËRFSHIRJA E INDUSTRIËSË SË HIDROENERGJISË NË PËRMIRËSIMIN E STANDARDEVE

Protokolli i Vlerësimit të Qëndrueshmërisë Hidroenergjetike (HSAP) është një mjet i përmirësuar i vlerësimit, i hartuar kryesisht për ndërtuesit, për të matur dhe udhëzuar veprimet në sektorin e hidroenergjetikës përsa i përket qëndrueshmërisë. HSAP vlerëson katër fazat kryesore të zhvillimit dhe zbatimit të projektit të hidroenergjisë: fazën e hershme, përgatitore, të zbatimit dhe operimit. Vlerësimet mbështeten në faktet për krijimin e profilin të qëndrueshmërisë në rreth 20 çështje pavarësisht nga faza relevante dhe mbulojnë fusha të gjerë aspektesh të qëndrueshmërisë.

HSAP është rezultat i punës intensive në mes të viteve 2008-2010 nga ana e Forumit për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë Hidroenergjetike, një organ me shumë palë të interesuara i cili përfaqëson OJQ sociale dhe mjedisore (Oxfam, The Nature Conservancy, Transparency International, WWF); qeveritë (kineze, gjermane, islandeze, norvegjeze, zambiane); bankat tregtare dhe të zhvillimit (Grupi i Institucioneve Kryesore Financiare të Ekuatorit, Banka Botërore), dhe sektorin e hidroenergjetikës, të përfaqësuar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Hidroenergjetikës (IHA).

HSAP është nisur zyrtarisht në Brazil në qershor të vitit 2010 dhe udhëhiqet nga këshilli shumëpalësh. Menaxhmenti i tij ndodhet brenda IHA në Londër. WWF International, i cili ka qenë i përfshirë direkt në krijimin e këtij mjeti të mrekulueshëm, përkrah fuqimisht përdorimin e tij nga sektori privat, sidomos në vendet të cilat nuk kanë legjislacion mbi EIA-të apo/ose SEA-të.

<http://hydrosustainability.org>





www.naturemade.ch
www.wwf.ch/it/index.cfm

„NATUREMADE STAR“ SKEMA E CERTIFIKIMI E KRIJUAR NË ZVICËR

Zvicra është një vend shumë i avancuar në sigurimin e hidrocentraleve që të shkaktojnë sa më pak ndikim të mundshëm në mjedis, duke zhvilluar njërin prej skemave më të mira të certifikimit në botë për energjinë e gjelbër: Margaritari i Natyrës, i cila është krijuar me përkrahje të WWF Zvicër, shoqatave të tjera mjedisore dhe të konsumatorëve dhe një numër kompanish elektrike.

Ky emërim i energjisë së rinovueshme i jepet atyre hidrocentraleve të cilat plotësojnë kushtet strikte mjedisore, përfshirë edhe rrjedhjen mjedisore, transportimin e sendimenteve, shkallët për peshqit dhe masat mbrojtëse për habitatet e ligatinave. Operatorët duhet gjithashtu të kontribuojnë në fondin për përmirësimin e mjedisit, përfshirë rehabilitimin e habitatit përpos kritereve të certifikimit, ndersa konsumatorët mund të vendosin ta blejnë energjinë e gjelbër me një çmim paksa më të lartë. Kompania që punon hidrocentralin, autoritetet lokale dhe organizatat mjedisore së bashku vendosin për ndarjen e fondit. Rreth 20 furnizues të energjisë elektrike në Zvicër kanë fituar këtë llojë certifikate.

„GOLD STANDARD: KREDITË E KUALITETIT PREMIUM TË KARBONIT“ NË ÇERTIFIKATË STANDARDE QË OFROHET SI ÇMIM PËR PROJEKTET E ZVOGËLIMIT TË KARBONIT

Gold Standard (Standardi i Artë - GS) njihet ndërkombëtarisht si pikë referimi për kualitet dhe saktësi në përmbushjen dhe tregjet vullnetare të karbonit. GS certifikon projektet e energjisë së ripërtëritshme dhe efikasitetit energjetike në menjanimin e karbonit për t'u siguruar që ato mundësojnë zvogëlimin e real dhe të përhershëm të gazrave sere (GHG) dhe përfitime të zhvillimit të qëndrueshëm në komunitetet lokale të vrojuara, raportuara dhe verifikuara.

I krijuar në vitin 2003 nga WWF, Standardi i Artë është standardi i vetëm i certifikimit i cili është i besuar dhe pranuar nga më tepër se 80 OJQ nga mbarë bota, përfshirë Care International, World Vision Australia, Forumi për të Ardhmën dhe Mercy Corps. Ai është gjithashtu standard të cilin e përzgjedhin qeveritë dhe kompanitë multinationale, përfshirë H&M, DHL, Swiss Post, Nokia, Virgin Atlantic, Panasonic, TUI Travel dhe FIFA.

Agjencitë e Kombeve të Bashkuara përdorin Standardin e Artë për zhvillimin e projekteve të tyre të zvogëlimit të karbonit dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Projektet e Standardit të Artë duhet t'i përmbahen kritereve të rrepta dhe transparente të vendosura nga Sekretariati, të mbikqyrura nga Komitetit i Pavarur i Këshillimit Teknik dhe verifikuar nga revizorët e pavarur të akredituar nga OKB. Ky proces certifikimi kërkon përfshirjen e pashembullt të palëve të interesuara lokale dhe OJQ-ve.

www.cdmgoldstandard.org

3 Implementimi i standardeve dhe garancive të performancës së Institucioneve Ndërkombëtare Financiare

Shumica e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFI-ve) kanë zhvilluar parimet, standardet dhe garancitë e tyre të qëndrueshmërisë përsa i përket kontrollit të projekteve të infrastrukturës para dhënies së huave. Ato do të kërkojnë të sigurohen që projektet të cilat i financojnë të jenë të qëndrueshëm nga aspekti social dhe mjedisor, të respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe komuniteteve të prekura dhe të jenë të krijuara dhe drejtura konform kushteve të vendosura rregulluese dhe praktikave të mira ndërkombëtare. Banka Botërore dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) kanë seri të “Standardeve të Performimit” të cilat janë azhurnuar së fundmi për të reflektuar sfidat siç janë efienca e burimeve, ndryshimet klimatike dhe të drejtat e njeriut.

IFI gjithashtu kanë bërë Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (ESIA) për të identifikuar, evituar dhe zvogëluar ndikimet e mundshme të dëmshme sociale dhe mjedisore të ndërlidhura me aktivitetet e tyre të huadhënies. Disa banka të mëdha ndërkombëtare dhe kombëtare për më tepër janë përfshirë në “Parimet e Ekuatorit” dhe “Parimet për Investime të Qëndrueshme”, një kornizë vullnetare e krijuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) përmes së cilës investitorët mund të përfshijnë çështjet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në proceset e vendimarrjes për të përafruar objektivat e tyre me ato të përgjithshme të shoqërisë.

<http://www1.ifc.org>
<http://www.equator-principles.com>
<http://www.unpri.org>

WWF kërkon më tepër kujdes në marrjen e vendimeve për diga:

1. Propozimet për hidrocentrale të reja duhet të plotësojnë standardet e pranueshme ndërkombëtare të qëndrueshmërisë (p.sh. udhëzimet e Komisionit Botëror të Digave, <http://www.dams.org/report>). Hidrocentralet e reja duhen marrë parasysh vetëm kur, pas vlerësimit të detajshëm, vërtetohet të paraqesin mundësinë më të mirë, përfshirë edhe krahasimin e efikasitetit energjetik, kursimeve dhe burimeve tjera të energjisë së ripërtëritshme.
2. Qeveritë duhet të ndalojnë skemat e hidrocentraleve – të mëdha apo të vogla – në disa prej lumenjve të paprekur (dhe në degët e tyre) në zonat me vlera të larta konservuese, duke krijuar “zona të ndaluara” (http://awsassets.panda.org/downloads/wwf_guide_water_for_life_web.pdf).
3. Duhet marr vendime në lidhje me vendndodhjen e hidrocentraleve për të minimizuar efektet mjedisore në tërësi të pellgun e lumit. Vendndodhjet e efikasit hydroenergjetike të cilat minimizojnë zonën e përmbajtjeve për njësinë e prodhuar të energjisë, duhet të kenë prioritet (por duke marrë parasysh pikën 2 më lartë).
4. Masat lehtësuese (p.sh. regjimet e rrjedhjes mjedisore, rehabilitimi dhe mbrojtja e habitateve, shkallët për peshqit) mund të zvogëlojnë në masë të madhe ndikimin e projekteve të hidrocentraleve dhe duhen çdo herë të planifikohen.
5. Çdo herë kur është e mundur, kapaciteti i hidrocentraleve ekzistuese duhet të rritet dhe infrastruktura ekzistuese të rindërtohet në mënyrë që të minimizohet nevojja për hidrocentrale të reja.
6. Hidrocentralet e vogla, të cilat furnizojnë zonat rurale në vendet në zhvillim me energji të rinovueshme, duhen të përfshijnë masa lehtësuese dhe duhet të merret parasysh ndikimi i tyre kumulativ.
7. Ndërtuesit duhet të sigurojnë një proces risistemi të drejtë të hidrocentraleve, konform parimeve të WCD, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara – përfshirë banorët e zhvendosur dhe përdoruesit poshtë rrjedhës – në marrjen e vendimeve.
8. Qeveria duhet të prioritetizoj një model të fortë energjetik, përfshirë masat e efikasitetit energjetik dhe zgjidhjet e ndryshme të energjisë së ripërtëritshme, për të balancuar ndikimet mjedisore dhe sociale dhe forcuar sigurinë energjetike.

PUNA E WWF NË BALLKANIN PËRENDIMOR

Që nga viti 2001, WWF ka adresuar qështjet për mbrojtjen e ujërave të ëmbëla në Ballkanin Përendimor – nga lumi Neretva dhe pellgu i Cetinës në Bosnje e Hercegovinë dhe Kroaci deri te Liqeni i Shkodrës që ndodhet në kufirin në mes të Malit të Zi dhe Shqipërisë. WWF fokusohet në parandalimin dhe minimizimin e ndikimeve të infrastrukturës ujore, posaçërisht digave, përmes promovimit të menaxhimit të integruar të pellgjeve të lumenjëve.

Kontakti

Angela Klauschen

Zyrtare për Politikën e Ujërave të Ëmbëla

WWF Mediterranean
aklauschen@wwfmedpo.org
 +390684497335

mediterranean.panda.org

Autore: Angela Klauschen

Faqesja: Catherine Roberts

Falenderime të posaçme për Ute Collier

Shtypur në letër FSC

Publikuar në qershor 2012 nga WWF – Fondit Botëror i Natyrës (ish Fondit Botëror i Jetës së Egër), Romë, Itali.

Cfarëdo ripërdorimi i pjesëshëm apo i tërësishëm duhet të citoj titullin dhe vlerësoj publikuesin si pronar të të drejtave të autorit.

© Text 2012 WWF. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



Why we are here

To stop the degradation of the planet's natural environment and to build a future in which humans live in harmony with nature.

mediterranean.panda.org